



Intervistë me prof. dr. Hasan Hanefi

## Globalizimi si formë e re e hegjemonisë perëndimore

**Profesori i filozofisë nga Egjipti, dr. Hasan Hanefi është një kundërshtar i vendosur i globalizimit. Në këtë ai sheh vetëm një formë të re të shtypjes e ndrydhjes nga ana e shteteve perëndimore.**

*Z. Prof. Hanefi, fillimisht ç'do të thotë globalizimi për ju? Me këtë term a nënkuptoni perëndimorizimin apo madje edhe amerikanizimin e botës?*

**Hasan Hanefi:** Globalizimi është një prej formave të hegjemonisë perëndimore. Me fillimin e modernes, Perëndimi ka sfiduar mbarë botën, duke filluar me rënien e Granadës dhe me zbulimin e hemisferës perëndimore të rruzullit tokësor, pra të Amerikës, dhe me të ashtuquajturat zbulime gjeografike, pikërisht në stilin kinse bota nuk kishte ekzistuar më herët para se të vinte njeriu i bardhë. Më vonë flotat nga Gjenova i kapërcyen detet dhe erdhi deri te një tregti e shtuar dhe gjithnjë në rritje në shek. XVII.

Më pas vjen kolonizimi i Algjerisë në shek. XIX, fundi i perandorisë mongole nga ana e anglezëve në Indi si dhe zgjerimi i Evropës në tërë botën e vjetër. Brenda vetëm dy shekujve, pasi dështuan kryqëzatat në shek. XI dhe XII, Evropa e nënshtroi mbarë botën. Pra globalizimi është një prej formave të njohura të tendencave hegjemoniste të Perëndimit, edhe atë jo vetëm përmes ushtrisë e ekonomisë, porse edhe përmes tregut. Pas fundit të polarizimit në vitin 1991 dhe fundit të regjimit socialist, u paraqit kapitalizmi si fitimtar, e më pas erdhi deri te legjitimimi i sistemit kapitalist në masë botërore, i cili bazohej në njësimin e tregjeve, në rregullat e tregut, në profit e në konkurrencë, aq sa shtetet e G7-she u bënë qendër e botës dhe mbarë bota, nga Afrika e Azia e deri në Amerikën Latine u shndërruan në tregje.

Sipas kësaj, globalizimi nuk nënkupton vetëm perëndimorizimin e botës, në kuptimin e zgjerimit të Perëndimit nga qendra drejt periferisë, dhe jo vetëm amerikanizimin e botës, pasi Amerika është e gjithë bota, meqë ka mbetur poli i vetëm që ekziston, porse ai nënkupton, dhe kjo është akoma më e rrezikshme, dominimin e një drejtimi, të një mendimi, të një ideje, të një ligji. Secili

shtet që merr guximin t'i rezistojë atij, si Afganistani, Iraku, Siria, Libani, Egjipti, Sudani, Arabia Saudite, Jemeni..., duhet të llogarisë në një agresion ushtarak, të miratuar ose jo nga ana e Kombeve të Bashkuara.

*Nëse e marrim për bazë këtë koncept të globalizimit, a mund atëherë të flasim edhe për një globalizim islam, sidomos nëse i marrim parasysh pushtimet islame ose zgjerimin e Islamit përmes tregtisë? Ekziston mendimi mjaft i përhapur se Islami dëshiron të dominojë botën, andaj a nuk kemi pasur një globalizim islam para se ta kemi globalizimin perëndimor?*

**Hanefi:** Shtrirja e një perandorie përtej kufijve të saj është një fenomen historik. Kur Aleksandri i Madh me ushtritë e tij u nis nga Athina drejt Egjiptit, Azisë së Mesme dhe Indisë, ky ishte një lloj globalizimi grek, sepse me këtë kultura greke mbisundoi kulturën barbare, jogreke.

E njëjta vlen edhe për Pax Romanën. Romakët dëshironin që Detin Mesdhe ta bënin një det romak. Më pas vjen Islami dhe përhapet pas luftërave të zhvilluara kundër persianëve e perandorisë bizantine. Mirëpo Islami nuk dëshironte dhe nuk përpiqej për hegjemoni. Pushtimet islame nuk kanë qenë invadime e luftëra për epërsi siç ishte rasti i Aleksandrit të Madh ose i kryqëzatave ose edhe i kolonizimeve moderne evropiane.

*Pse Islami të ketë qenë ndryshe, kur edhe ai është përhapur e shtrirë dhe një pjese të madhe të botës ia ka imponuar pushtetin e vet?*

**Hanefi:** Islami është nisur nga ideja e besimit në një Zot dhe kjo do të thotë se bota mbarë është e barabartë përpara një Zoti të vetëm, se ajo i nënshtrohet një parimi të vetëm dhe vlerave të njëjta humaniste, pa marrë parasysh përkatësinë racore ose kombëtare. Islami nuk ka vrarë fëmijë apo pleq, nuk ka rrënuar shtëpi, siç vepron Izraeli sot në Palestinë. Kur muslimanët arabë kanë ardhur në Egjipt, nga ana e egjiptianëve janë pritur si çlirues.

Islami nuk ka ardhur si zaptues, porse si çlirues i popujve. Ai i ka respektuar kulturat e popujve, gjuhët dhe fetë e tyre. Kush ka jetuar në paqe me Islamin, ai e ka ruajtur fenë e vet. Kështu ka qenë me çifutët, me të krishterët, me sabiitët dhe me brahmanët, po madje dhe me idhujtarët. Sistemi islam i „miletit” në perandorinë osmane ka qenë një formë e kombit federal. Të gjithë popujt janë nën mbrojtjen e Islamit dhe kanë mundësinë ta ruajnë kulturën dhe traditën e tyre. Në Andaluzi, konkretisht në Granadë, në Sevilë, në Kordobë ose Toledo nuk ka pasur asnjë armiqësi të Islamit ndaj çifutëve dhe të krishterëve. Averroesi (filozofi musliman Ibni Rushdi - sh.p.) dhe Moses Maimonidesi (filozof çifut – sh.p.) madje kanë diskutuar e zhvilluar debate me njëri-tjetrin. Për këtë arsye, kjo periudhë për çifutët e Andaluzisë është quajtur si periudhë e artë.

*Unë dëshiroj t'i kthehem konceptit të perëndimorizimit të botës. A bëni ju ndonjë dallim midis SHBA-ve dhe Evropës? A mund ta paramendoni një afrim më të madh midis Evropës dhe botës islame ose arabe përballë një amerikanizimi gjithnjë në rritje, apo mos ndoshta fjala “Perëndim” për ju nënkupton në të njëjtën kohë edhe Evropën edhe SHBA-të?*

**Hanefi:** Unë nuk thash se nuk bëj dallim midis Perëndimit dhe Amerikës. Perëndimi zë një pozitë ndërmjetësi midis Amerikës, e cila dëshiron të dominojë gjithë botën, dhe botës joevropiane dhe joamerikane. Kjo shihet qartë në qëndrimin që ka Evropa ndaj çështjes së Palestinës ose të Irakut, të Iranit dhe të gjitha vendeve që kanë qenë koloni të Evropës, para se Amerika ta trashëgonte

Britaninë e Madhe, Francën, Holandën, Spanjën dhe Portugalinë, pra fuqitë tradicionale kolonialiste.

Pra vetë Perëndimi e lufton amerikanizimin dhe globalizimin. Kundërshtimi më i madh ndaj globalizimit vjen nga Franca, pasi globalizimi nuk është përhapur vetëm në formë të një hegjemonie ekonomike përmes tregut dhe ligjeve të tregut, porse edhe në formë të kulturës.

Kultura që e shoqëron globalizimin, konsumi, konkurrenca dhe profiti, pra këto vlera amerikane, janë përhapur përmes globalizimit. Një shtet që e nënshkruan Marrëveshjen GATT të Organizatës Botërore të Tregtisë, duhet t'u nënshtrohet rregullave të tregut në një botë jo të barabartë. Si mund Egjipti të hyjë në një konkurrencë me Detroitin ose Japoninë në prodhimin e veturave?

Sapo e nënshkroi Egjipti Marrëveshjen GATT, ai u mundua të eksportojë prodhime të tekstitit në Amerikë, pasi ky prodhim kishte një traditë të gjatë në Egjipt. Ndërkaq Amerika e refuzon këtë dhe të tërën e kthen prapë. Rregullat e tregut nënkuptojnë ofertën dhe kërkesën. Mirëpo a mundem unë ta bëj të njëjtën gjë dhe ta kthej prapë një veturë kur të më vijë nga Detroiti?

Sa zezakë amerikanë janë eksploatuar, sa shkelje të të drejtave njerëzore janë kryer? Unë jam i vogël, i dobët, nuk mund t'i imponohem askujt. Prandaj, globalizimi nënkupton matjen me masa të dyfishta dhe se ligjet e tregut dhe liria e konkurrencës vlejnë vetëm për fuqitë e mëdha. Shtetet e vogla duhet të mbesin jashtë, ato shërbejnë vetëm si tregje të lëndës së parë dhe të fuqisë së lirë punëtore.

Evropa luan një rol ndërmjetësi, shpengimi midis botës afrikane dhe aziatike nga njëra anë dhe amerikanizimit të botës nga ana tjetër. Ekziston një dallim midis perëndimorizimit dhe amerikanizimit. Islami tani është bërë feja e dytë më me rëndësi në Evropë, prandaj edhe interesat e Evropës qëndrojnë në jug të Mesdheut. Veriu dhe jugu janë të lidhur me njëri-tjetrin përmes emigrimit dhe një historie të përbashkët. Hegjemonia amerikane në emër të globalizimit do të jetë e dëmshme si për interesat e Evropës ashtu edhe për ato të botës arabe-islame.

*A është globalizimi një rezultat i rënies së Bashkimit Sovjetik, superfuqisë së dytë botërore?*

**Hanefi:** Jo, nuk është rezultat i rënies së Bashkimit Sovjetik, porse rënia e kësaj superfuqie kapitalizmit i ka dhënë një legjitimitet të ri. Ajo i ka dhënë një bazë teorike për dominimin botëror në emër të globalizimit.

*Po të ekzistonte akoma Bashkimi Sovjetik, a do të zhvillohej atëherë pak më ndryshe globalizimi?*

**Hanefi:** Gjithsesi. Atëbotë ishte lufta e ftohtë dhe bota dominohej nga dy bloqe, nga ai socialist dhe ai kapitalist. Pyetja ishte, cili prej dy sistemeve do ta mundte tjetrin. Jo përmes luftës, po përmes konkurrencës. Atëbotë sistemi socialist i mbështeste lëvizjet çlirimtare dhe p.sh. në Egjipt e ndërtoi pendën e ujit.

Afrika, Azia dhe Amerika Latine kishin përshtypjen se mund të kishin edhe një aleat tjetër pos Evropës dhe SHBA-ve. Kapitalizmi nuk kërkonte legjitimitet e tij, sepse ekzistonte socializmi përmes fuqisë së tij teorike dhe ideologjike. Mirëpo tani, pas shembjes së sistemit socialist, ekziston një ideologji e re e kapitalizmit, daç ta quajmë atë globalizim, “fshat global”, “revolucion i teknologjisë së komunikimit”, “fondi i historisë”, daç “luftë e kulturave”. Përveç kësaj, ajo është e zënë edhe me punë të tjera – p.sh. me Islamin dhe Konfuçianizmin kundër Judaizmit dhe Krishterimit, për t'i maskuar interesat e mëdha të vendeve prodhuese.

Ndërkaq ne duhet të merremi me punë të tjera: me “qeverisjen e mirë” si alternativë për shtetin komb të dobët e të korruptuar; me krijimin e një shoqërie civile, që të na japë një baraspeshë në jetën tonë midis fuqisë së shtetit dhe dobësisë së shoqërisë; me mbrojtjen e pakicave, me qëllim

që regjioni të shndërrohet në një mozaik të përbërë prej arabëve, berberëve, kurdëve, druzëve, sunnitëve, shiitëve etj. dhe me qëllim që Izraeli, shteti më i madh në regjion i mbështetur në fenë, në vend të legjitimacionit qiellor të fitojë një të tillë tokësor.

Pra, globalizimi është vetëm një pikë e agjendës perëndimore, të një agjende alternative për ne, në mënyrë që ne të merremi me temën e transformimit demokratik të shoqërive tona. Domethënë, Perëndimi beson se nuk është okupimi i Izraelit njëri prej problemeve tona, porse regjimet politike, dhe se çështja e një çlirimi kombëtar dhe e drejta ndërkombëtare duhen trajtuar në nivelin e një koncepti pastër individualist të të drejtave njerëzore.

*Në mbarë botën islame ne kemi mundësinë të vërejmë një përhapje dhe përforcim të lëvizjes islamiste. A e shihni ju këtë si një reaksion ndaj globalizimit?*

**Hanefi:** Jo, përhapja e lëvizjes islame është më e vjetër se globalizimi, ajo ka qenë një reaksion ndaj kolonializmit tradicional. Ajo ka filluar me el-Afganiun, Muhammed Abduhunë, Rashid Ridanë, Hasan el-Bennanë dhe Vëllezërit Muslimanë. Me el-Afganiun kanë filluar renesanca islame dhe reformat fetare. Islami asokohe duhej ta luftonte kolonializmin nga jashtë dhe represionin e ndrydhjen nga brenda.

Më pas lëvizja islame është përhapur edhe më tej, kur ideologjitë laiciste të modernes u dobësuan, kur liberalizmi sundonte në Egjipt në gjysmën e parë të shek. XX, kur socializmi dhe nacionalizmi sundonin në një pjesë të botës arabe në gjysmën e dytë të shek. XX. Kështu lindi diçka si një kthim ndaj Islamit si alternativë për ideologjitë e dobëta laiciste të modernes. Më pas vjen dështimi i vitit 1967.

Po ashtu edhe fillimi i rezistencës në Liban dhe në Palestinë, pavarësimi i republikave islame në ish-Bashkimin Sovjetik si dhe ngritja ekonomike e Malajzisë e Indonezisë i kanë kontribuar kësaj çështjeje. Përhapja e lëvizjes islame është më e vjetër se globalizimi, mirëpo globalizimi i ka dhënë asaj një shtytje të re, pasi Perëndimi, dhe sidomos SHBA-të, u paraqitën si një lloj i ri i kolonizatorëve.

*Ka disa intelektualë muslimanë që punojnë në një projekt islamik si alternativë për globalizimin dhe të cilët pohojnë se në një sistem islam gjithëbotëror do të kishte më pak krime apo raste të SIDA-s etj. A i përkrahni ju këto projekte?*

**Hanefi:** Kjo është një ëndërr, një mendim plot shpresë. Mirëpo bota islame nuk është vetëm një ide, ajo është një realitet shoqëror dhe politik: të përçarë e të dobët ne jemi të varur prej të tjerëve në aspekt të artikulave ushqimorë, të veshmbathjes, armëve, arsimimit etj. Ndoshta kjo është një ëndërr utopike për në të ardhmen, si ideologji alternative ndaj globalizimit. Pyetja është, nga vjen ai poli tjetër, i cili do t'i kundërvihet SHBA-ve?

Në Amerikën Latine ka trazira sociale, krime, drogë dhe Che Guevara është harruar që moti. Afrika kërcënohet nga borxhet, lufta civile, sëmundjet si SIDA si dhe nga zgjerimi i shkretëtirës. Kështu që mbetet vetëm bota arabo-islame, në të cilën akoma ka diçka si gjallëri shpirtërore e ideore, një ruajtje të identitetit, diskutime të rëndësishme. Ndoshta Islami në këtë regjion do të jetë në pozitë të bëhet poli i dytë përballë SHBA-ve – pas fundit të socializmit. Mirëpo kjo mund të ndodhë në një të ardhme të largët.

Nga një shikim më i përafërt, ne nuk kemi opsion tjetër, pos t'i përforcojmë shtetet nacionale, t'i ndihmojmë e përkrahim lëvizjet çlirimtare në Palestinë, Kashmir, Ceuta dhe Melilla dhe të krijojmë një kooperim regjional, një treg të përbashkët arab. Egjipti, Indonezia, Malajzia, Turqia, Irani, Nigeria etj. e kanë formuar “Grupin e 14-shes”, të cilit i janë bashkëngjitur edhe 14 shtete

të tjera. Ky është një union afrikano-aziatik, që mund të përbëjë një pol kundër tregut të bashkuar evropian. Mirëpo, që bota islame vetë të jetë në gjendje t'i futet konkurrencës me Perëndimin, kjo është një ëndërr.

*Globalizimi ka edhe anët pozitive të tij. Deri diku përforcimi i vetëdijes globale rreth ndotjes së mjedisit ose mundësia për të formuluar të drejta njerëzore që do të vlenin për mbarë botën. Si e shihni ju këtë?*

**Hanefi:** Kjo s'është e saktë. Kjo është një legjendë. Globalizimi e ka përçarë botën dhe në epokën e globalizimit kanë ndodhur padrejtësitë më të mëdha, jo vetëm në sferën e të drejtave njerëzore, por edhe të atyre ndërkombëtare. Ç'u bë me Palestinën, me Kashmirin në periudhën e globalizimit? Çka ndodhi kur Maroku e kërkoi të drejtën e tij dhe kur doli kundër kolonizimit spanjoll të Ceutës, Melillës dhe ishujve Petersilien? Ç'u bë me zaptimin e Gjibraltarit nga ana e Britanisë dhe Spanjës? Të drejtat njerëzore? Ku janë të drejtat ndërkombëtare? Përse gjithnjë flitet për të drejtat e njeriut, që janë të bazuara në një koncept individual evropian për njeriun? Ku është e drejta për vetëvendosje e popujve?

Ne qysh në vitin 1977 pas çlirimit kombëtar në Algjeri e kemi shpallur Deklaratën universale të të drejtës njerëzore" (Universal Declaration of Peoples Right). Te globalizimi unë vërtet nuk shoh kurrfarë përparësie. Kush përfiton nga përparësitë e "shtetit global"? Ruanda, Eritreja, Etiopia, Somalia? Krejt kjo shkon në llogari të interesave evropiane.

*Po ç'është puna me përhapjen e teknologjisë perëndimore në botën arabe ose në atë të tretën, si kompjuteri ose mjetet e tjera të komunikimit?*

**Hanefi:** Kjo ka të bëjë vetëm me teknologjinë e thjeshtë, e jo edhe me High-Tech, teknologjinë e lartë. Ajo mbetet në duart e fuqive perëndimore. Information is power (Informimi është fuqi).

*E pra çka mund të bëhet? Ju folët për një bashkëpunim regjional, për një treg të përbashkët të vendeve arabe ose të vendeve të botës së tretë. A është kjo një alternativë për globalizimin?*

**Hanefi:** Jo, unë kam për qëllim një botë multipolare. Tekefundit, kush do ta mbështesë pastaj globalizimin përpos koncerneve të mëdha? A mendoni për demonstratat në Seattle, Gjenovë, Paris, Londër dhe Pragë? Kjo është e ardhmja e Evropës, që po ashtu del kundër globalizimit sikur bota arabe-islame.

Intervistoi: Larissa Bender dhe Mona Naggar

Titulli origjinal: „Globalisierung als neue Form westlicher Hegemonie“, [www.qantara.de](http://www.qantara.de)

Nga gjermanishtja: mr. Rejhan Neziri